

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare te mbyllura me 31 Dhjetor 2022

(Shumat jane shprehur ne Lek, pervec rastit kur specifikohet monedha tjeter)

1. Te pergjithshme

Shoqeria IKONA shpk eshte themeluar me 22/10/2002, me objekt aktiviteti kryesor "Tregtimi me shumice dhe pakice i mallrave industriale". Ajo eshte regjistruar ne QKB me NIPT K27222201B dhe adresa e selise eshte Tirane, Lagjja e vjetër, Vaqarr. Shoqeria Ikona shpk drejtohet nga administratori Lefter Sota, gjithashtu ortaku i vetern i shoqerise.

Gjate vitit 2022 shoqeria ka patur 38 te punesuar.

2. Bazat e pergatitjes

(a) Deklarata per pajtueshmeri

Pasqyrat Financiare jane pergatitur ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF).

(b) Bazat e matjes

Pasqyrat Financiare jane pergatitur duke u bazuar ne koston historike, perjashtuar derivativet financiar (n.q.s ka), instrumentat financiare me vlere te drejte permes fitimit e humbjes dhe aktivet financiare te vlefshme per shitje, te cilat maten me vlere te drejte (n.q.s ka).

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat Financiare jane pasqyruar ne LEK e cila eshte monedha funksionale e shoqerise.

(d) Perdorimi i gjykimeve dhe hamendesimeve

Paraqitja e Pasqyrave Financiare kerkon qe manaxhimi te beje vleresime, gjykime e supozime qe ndikojne ne aplikimin e politikave kontabel. Vleresimet dhe supozimet rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e vletesimeve kontabel njihen ne periudhen kur ndodh rishikimi dhe ne cdo periudhe te ardhme qe preket.

(e) Vijueshmeria

Drejtuesit e shoqerise kane bere nje vleresim te aftesise se shoqerise per vijueshmerine e aktivitetit duke rnarre parasysh te gjithë faktoret e theksuar me lart dhe jane te kenaqur qe shoqeria ka burime per te vazhduar aktivitetin per nje te ardhme te parashikueshme. Per me teper, drejtuesit nuk jane ne dijeni te ndonje pasigurie materiale qe mund te hedhe dyshime te medha mbi vijueshmerine e shoqerise. Prandaj Pasqyrat Financiare jane pergatitur mbi bazen e parimit te vijueshmerise.

3. Ndryshimet ne politikat kontabel dhe ne dhenien e shpjegimeve shtese

Standarde dhe interpretime te reja dhe te ndryshuara

Njesia ekonomike ka aplikuar per here te pare, disa standarde dhe ndryshime, te cilat jane efektive per periudhat vjetore qe fillojne nga 1 Janari 2022 e me pas. Njesia ekonomike, per shkak te madhesis se saj ka pergatitur pasqyrat financiare te vitit 2022 sipas standardeve nderkombetare te raportimit financiar SNRF.

4. Politikat kontabel te rendesishme

(a) Transaksionet ne monedha te huaja

Gjendjet e llogarive ne monedhe te huaj jane perkthyer ne monedhen vendase me kursin zyrtar te mbylljes se Bankes se Shqiperise ne daten e bilancit. Diferencat e konvertimit si pasoje e perkthimit te monedhave te huaj ne Lek jane njohur ne pasqyrat e te ardhrave dhe shpenzimeve per periudhen e raportimit. Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare ne monedhe te huaj te vleresuar me koston historike, jane raportuar me kursin historik te monedhes se huaj ne daten e transaksionit.

(b) Instrumentat financiare

Shoqeria zoteron vetem instrumente financiare jo-derivative qe perfshijne llogari klientesh, rnjete monetare, dhe llogari te tjera per tu paguar apo per tu arketuar me karakter tregtar. Instrumentet financiare jo-derivative jane rregjistruar fillimisht sic pershkruhet me poshte:

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre perfshijne parate ne dore, depozitat ne banka, investime afatshkurtra me likuiditet te larte dhe afat maturimi me pak se tre muaj te cilat nuk jane subjekt i riskut te ndryshimit te vleres se drejte dhe perdoren nga shoqeria ne manaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

Llogarite e klienteve dhe llogari te tjera te arketueshme

Llogarite e klienteve dhe llogari te tjera te arketueshrne fillimisht jane regjistruar me vleren e drejte dhe me pas jane vleresuar me koston e tyre te amortizuar minus humbjet nga zhvleresimi.

Llogarite e furnitoreve dhe te tjera llogari te pagueshme

Llogarite e furnitoreve dhe te tjera llogari te pagueshme jane rregjistruar fillimisht me vleren e drejte dhe me pas jane vleresuar me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv

(c) *Inventaret*

Shoqeria ka vleresuar gjendjet e inventarit ne daten e mbylljes se bilancit duke perdorur metoden e me te vogles midis koston se blerjes dhe vleres neto te realizueshme.

(d) *Ndertesa, makineri e paisje*

(i) *Njohja dhe matja*

Ndertesa, makinerite e pajisjet maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe cdo humbje te akumuluar nga zhvleresimi. Te gjitha aktivet afatgjate jane pasqyruar me koston e blerjes. Kosto e blerjes perfshin shpenzimet e lidhura drejtperdrejt me blerjen e aktivit.

Kur pjese perberese te aktivitet kane jete te dobishme te ndryshme, ato mbahen si zera te vecante te aktiveve afatgjate materiale. Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashte perdorimit e nje elementi te aktivitet afatgjate material percaktohen nga krahasimi i te ardhurave nga nxjerrja jashte perdorimit me vleren e mbartur te aktivitet, dhe paraqiten neto ne seksionin e te ardhurave te tjera ne pasqyren e te ardhurave e shpenzimeve.

(ii) *Kostot vijuese*

Kosto e zevendesimit te nje pjese perberese te nje prej aktiveve materiale afatgjate, njihet ne vleren e mbartur te aktivitet, nese eshte e mundur qe Shoqeria do te kete perfitime ekonomike te ardhshme nga ky veprim dhe kostoja e tij mund te matet me besueshmeri. Vlera e mbartur e pjeses se zevendesuar cregjistrohet, Kostot e sherbirneve te perditshrne te aktiveve materiale afatgjate njihen ne shpenzimet e periudhes kur ndodhin.

(iii) *Zhvleresimi*

Amortizimi llogaritet sipas metodes se vleres se mbetur te aktivitet ne fund te cdo viti, e cila eshte kosto historike minus amortizimin e akumuluar. Ne perputhje me SNK 8 Politikat Kontabel, Ndryshimet ne Vleresimet Kontabel dhe Gabimet, ndryshimet ne jeten ekonomike te aktiveve trajtohen si ndryshime te hamendesive dhe zbatohen ne menyre prospektive. Per vitin 2022, norma vjetore e amortizimit nuk ka ndryshuar.

<i>Emertimi</i>	<i>Metoda e amortizimit</i>	<i>Norma vjetore</i>
Ndertesa	Mbi vleren fillestare	5%
Makineri	Mbi vleren e mbetur	20%
Mjete Transporti	Mbi vleren e mbetur	20%
Pajisje zyre (mobilje)	Mbi vleren e mbetur	20%
Pajisje Elektronike	Mbi vleren e mbetur	25%

(e) Zhvleresimi i aktiveve jo financiare

Vlera e mbartur e aktiveve jo-financiare me perjashtim te taksave te shtyra, rishikohet cdo periudhe raportuese per te percaktuar nese ka ndonje indikator per zhvleresim. Nese ekziston ndonje indikacion i tille, atehere behet vleresimi i shumes se rikuperueshme te aktivitet. Ne kete menyre nje humbje nga zhvleresimi regjistrohete nese vlera e mbartur ne kontabilitet e ketij aktivi e tejkalon vleren e rikuperueshme. Keto humbje nga zhvleresimi pasqyrohen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

(f) Perfitimet e punonjesve

Shoqeria, gjate aktivitetit te saj, kryen pagesa ne erner te saj dhe te punonjesve te saj, per te kontribuar ne skemat e pensionit ne perputhje me legjislacionin lokal ne fuqi. Qeveria e Shqiperise eshte pergjegjese per te ofruar pensionet ne Shqiperi sipas nje plani te percaktuar te kontributit. Kostoja e perballuar nga Shoqeria regjistrohete ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve ne periudhen kur sherbimet jane marre nga punonjesit.

(g) Provizionet per rreziqe

Provizionet per rreziqe pranohen kur shoqeria ka nje detyrim aktual (ligjor apo te pranuar terthorazi), si rezultat i ndodhive ne te kaluaren dhe ka gjasa qe permbushja e ketyre detyrimeve kerkon sakrifikimin e burimeve ne pronesi te shoqerise te cilat do te sillnin perfitime ekonomike ne te ardhmen, dhe shoqeria ka mundesi te percaktoje besueshem vleren e ketyre rreziqeve. Provizionet percaktohen duke bere skontimin e shumave te parashikuara per tu paguar ne te ardhmen me nonnat e skontimit para tatimit qe reflektojne vleresimin aktual te tregut per vleren ne kohe te parase dhe te rreziqeve specifike te ketij detyrimi.

(h) Njohja e te ardhurave

Te ardhurat nga sherbimet njihen ne momentin kur sherbimi kryhet, ndersa te ardhurat nga shitja e mallrave njihen kur ndryshimi i pronesise se bashku me riskun qe vjen nga ky ndryshim, jane transferuar tek bleresi.

(i) Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhurat nga interesat per llogarite bankare, fitimet nga shitja aktiveve financiare te mbajtura per shitje, dhe perfitimet nga diferencat e kursit te kembimit. Interesat njihen ashtu sic perllogariten duke perdorur metoden e interesit efektiv. Shpenzimet financiare perfshijne shpenzimet per interesa, humbjet nga diferencat e kembimit dhe humbjet nga zhvleresimi i aktiveve financiare. Fitimet dhe humbjet ne monedhe te huaj raportohen ne baza neto.

(j) Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin perfshin tatimin e shtyre dhe ate aktual. Tatimi mbi fitimin paraqitet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve perjashtuar rastet kur lidhet me zerat e kapitalit e per rrjedhim paraqitet ne kapital.

Tatimi aktual eshte tatimi i parashikuar per tu paguar, i perllogaritur mbi fitimin e tatueshem per vitin, duke perdorur normat tatimore ne fuqi ne daten e bilancit si dhe cdo korrjgjim te tatimit te pagueshem te periudhave te meparshrne.

5. Percaktimi i vleres se drejte

Nje pjese e politikave kontabel dhe shenimeve shpjeguese te Shoqerise kerkojne percaktimin e vleres se drejte per aktivet dhe detyrimet financiare ose jo financiare. Vlera e drejte eshte percaktuar per qellime te matjes apo shenimeve sipas metodave te meposhtme. Kur eshte e nevojshme dhenia e informacioneve shtese per supozimet e bera ne percaktimin e vleres se drejte, ato shtohen ne seksionin e shenimeve te aktivitet apo detyrimit ne fjale.

6. Menaxhimi i riskut financiar

Shoqeria eshte ekspozuar ndaj risqeve te meposhtme si pasoje e perdorimit te instrumentave financiare:

- Risku i kredise
- Risku i likuiditetit
- Risku i tregut
- Rreziku i iinteresit
- Rreziku i kursit te kernbimit te monedhave te huaja

Ky shenim jep informacion rreth ekspozimit te shoqerise ndaj secilit prej llojeve te risqeve, objektiveve, politikave dhe proceseve per matjen dhe menaxhimin e riskut si dhe menaxhimin e kapitalit te shoqerise.

Risku i kredise

Rreziku i mospageses ekziston kur pala tjetër nuk mund të përmbushë detyrimet për pagesën e llogarive të arketueshërve. Maksimumi i rrezikut të kredise për instrumentet financiare jo-derivative është teorikisht i barabartë me vlerën e drejtë të të gjitha llogarive të arketueshërve minus detyrimet kundrejt të njëjtit debitor kur kompensimi është i lejuar. Rreziku i kredise i cili është identifikuar merret parasysh nepermjet zhvleresimeve. Shoqëria ka politikë për të siguruar se shitjet e mallrave dhe shërbimeve janë bërë për klientet me një histori krediti të përshtatshme, Shoqëria ka politikë që kufizojnë sasinë e ekspozimit të kredise për çdo kundër parti.

Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria të hasë vështirësi për të plotësuar detyrimet financiare që shlyhen duke dhënë mjete monetare ose aktive të tjera financiare. Qëndrimi i Shoqërisë në manaxhimin e likuiditetit është të sigurojë se do të ketë gjithmonë likuiditet të mjaftueshëm për të përballuar detyrimet kur ato maturohen, si në kushte normale dhe të vështira, pa pësuar humbje të papranueshërve apo demtuar reputacionin e shoqërisë.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku që ndryshimet në çmimet e tregut, siç janë kurset e këmbimit dhe normat e interesit, do të prekin rezultatin e Shoqërisë. Objektivi i manaxhimit të riskut të tregut është manaxhimi dhe kontrolli i ekspozimit ndaj riskut të tregut, brenda parametrave të pranueshëm dhe duke optimizuar kthimin.

Risku i interesit

Shoqëria nuk ndeshet me risk interesit të flukseve monetare sepse ajo nuk ka instrumente financiare me norma të varjueshme.

Risku i monedhes së huaj

Shoqëria nuk ndeshet me risk të lartë të monedhes së huaj nga aktiviteti normal i saj

7. Aktive afatgjate materiale

Aktive afatgjate materiale paraqiten në tabelën më poshtë:

Aktivitet Afatgjate Materiale me vlerë fillestare 31.12.2022

Emertimi

Gjendje

Shtesa

Pakesime

Gjendje

	01/01/2022		31/12/2021	
Toka	349,863,408	-		349,863,408
Ndertime	89,948,415			89,948,415
Makineri,paisje	236,145,028	2,865,290		239,010,318
Mjete transporti	54,490,806	6,963,970		61,454,776
Instrumenta e vegla pune etj	41,886,602	-		41,886,602
Zyre	833,459	241,520		1,074,979
P.INFORMATIKE	758,274			758,274
TOTALI	773,925,992	10,070,780	0	783,996,772

Amortizimi A.A.Materiale 31.12.2022

Emertimi	Gjendje 01/01/2022	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2022
Toka	0	-		0
Ndertime	45,897,551	2,202,543		48,100,094
Makineri,paisje,vegla	150,704,100	17,139,155		167,843,255
Mjete transporti	42,494,552	3,338,854		45,833,406
Instrumenta e vegla pune etj	36,434,420	1,090,437		37,524,857
Zyre	459,400	119,092		578,492
P.INFORMATIKE	645,521	28,189		673,710
TOTALI	276,635,544	23,918,270	0	300,553,814

Vlera Kontabel Neto e A.A.Materiale 31.12.2022

Emertimi	Gjendje 01/01/2022	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2022
Toka	349,863,408		-	349,863,408
Ndertime	44,050,864		2,202,543	41,848,321
Makineri,paisje,vegla	85,440,928	2,865,290	17,139,155	71,167,063
Mjete transporti	11,996,254	6,963,970	3,338,854	15,621,370
Instrumenta e vegla pune etj	5,452,182	-	1,090,437	4,361,745
Zyre	374,059	241,520	119,092	496,487
P.INFORMATIKE	112,753		28,189	84,564
TOTALI	497,290,448	10,070,780	23,918,270	483,444,488

8. Aktive afatgjate jomateriale

Shoqeria nuk ka aktive afatgjate jomateriale

9. Llogari per tu arketuar (kliente)

Llogarite e arketueshme nga kliente perbehen:

Pershkrimi	31.12.2022	31.12.2021
Kliente nga shitja e mallrave	1,882,853,053	1,386,836,607
Kliente te tjere		
Totali	1,882,853,053	1,386,836,607

10. Llogari per tu arketuar (te tjera)

Llogarite te tjera te arketueshme perbehen si me poshte

Pershkrimi	31.12.2022	31.12.2021
Kliente nga shitja e mallrave	804,241,540	823,302,241
TVSH kreditore	22,772,699	
Parapagim per detyrime doganore	58,752,222	
Te tjera		
Totali	885,766,461	823,302,241

11. Inventari

Inventari perbehet kryesisht nga mallra, lende te para per ndertim si hekur etj.

Pershkrimi	31.12.2022	31.12.2021
Mallra	163,639,094	371,290,358
Te tjera		
Totali	163,639,094	371,290,358

12. Mjete monetare dhe ekuivalente te tyre

Mjete monetare dhe ekuivalente te tyre perbehen nga

Pershkrimi	31.12.2022	31.12.2021
Banka	41,787,650	111,565,695

Arka		
Te tjera		
Totali	41,787,650	111,565,695

13. Kapitalet e veta

Kapitalet e veta te shoqerise perbehen nga

Pershkrimi	31.12.2022	31.12.2021
Kapitali i nenshkruar dhe primi i kapitalit	392,968,840	392,968,840
Rezerva te tjera (ligjore)	18,757,278	18,757,278
Fitime/(humbje) te mbartura	697,567,722	388,690,966
Fitime/(humbje) te vitit	508,151,510	308,876,756
Totali	1,617,445,350	1,109,293,840

Kapitali i nenshkruar perbehet nga:

	Njesi	1
Vlera nominale per pjese	Lek/Njesi	392,968,840
Totali i kapitalit te nenshkruar	Lek	392,968,840
Kapitali zoterohet nga:	100%	392,968,840
Lefter Sota		

14. Detyrime afatgjate

Detyrimet afatgjata perbehen:

Pershkrimi	31.12.2022	31.12.2021
Hua bankare	260,014,977	284,681,224
Te tjera		
Totali	260,014,977	284,681,224

15. Llogari per tu paguar (furnitore)

Llogarite e pagueshme per furnitore perbehen si me poshte

Pershkrimi	31.12.2022	31.12.2021
Furnitore te vitit ushtrimor	770,630,830	1,034,669,368
Furnitore mbi nje vit		
Totali	770,630,830	1,034,669,368

16. Detyrime ndaj organeve tatimore

Detyrimet ndaj institucioneve tatimore perfaqesojne detyrimet qe i perkasin muajit Dhjetor te cilat do te paguhen ne fillim te vitit te ardhshem ushtrimor

Pershkrimi	31.12.2022	31.12.2021
Sigurime shoqerore dhe shendetsore	486,554	
Tatim mbi te ardhurat e personale	57,200	
Tatim mbi fitimin	40,041,589	22,656,915
Totali	40,585,343	22,656,915

17. Te tjera detyrime afatshkurter

Te tjera detyrime afatshkurtra perbehen si me poshte:

Pershkrimi	31.12.2022	31.12.2021
Hua bankare overdraft	330,855,400	230,471,583
Hua te tjera	438,502,601	508,512,424
Totali	769,358,001	738,984,007

18. Te ardhurat

Te ardhurat nga aktiviteti reflektohen si me poshte

Pershkrimi	31.12.2022	31.12.2021
Shitje mallrash	6,642,268,915.31	5,300,767,651
Transport per te tretet	149,279.86	112,049
Te ardhura nga shitja AAM	1,523,728.80	3,981,227
Totali	6,643,941,924	5,304,860,928

19. Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme

Ky ze perbehet nga:

Pershkrimi	31.12.2022	31.12.2021
Blerje /shpenzime te materialeve	29,223,886	
Blerje /shpenzime mallra	5,800,360,969	4,766,828,246
Totali	5,829,584,855	4,766,828,246

20. Shpenzime per personelin

Shpenzimet per personelin perfshijne pagat dhe sigurimet per stafin e shoqerise, si me poshte:

Pershkrimi	31.12.2022	31.12.2021
Pagat dhe shperblimet e personelit	20,594,269.00	18,122,284
Sigurimet shoqerore dhe shendetesore	3,442,118.50	3,046,646
Totali	24,036,387.50	21,168,930

21. Shpenzime te tjera shfrytezimi

Shpenzimet e tjera te shfrytezimit perbehen nga:

Pershkrimi	31.12.2022	31.12.2021
shp energji	4,006,758	3,876,239
gazoil		9,488,448
blerje/shp te tjera	1,066,997	230,304
Mirembajtje	274,423	5,000
Prim sigurimi	11,730,320	471,020
Sherbime nga te tretet	42,560,991	26,191,936
Transferime, dieta, udhetim	1,673,413	1,057,012
Shp postare dhe telek.	344,969	241,861
Transport ne blerje	36,876,142	32,024,340
Komisione bankare	3,310,087	1,290,789
Taksa vendore	2,698,325	1,847,685
Taksa te tjera	158,392	84,029
Vlera kontabel e aqt shitura	1,523,729	3,901,602
Shp tjera zakonshme	447,364	687,800
Shpenzime te tjera per personelin	827,552	
Totali	107,499,464	81,398,065

22. Te ardhura dhe shpenzime financiare

Te ardhura dhe shpenzime financiare perbehen si me poshte

Pershkrimi	31.12.2022	31.12.2021
Shpenzime per interesa	(35,415,443)	(40,388,042)
diferenca kembimi	(25,662,199)	5,842,048
Rezultati neto	(61,077,642)	(34,545,994)

23. Rezultati tatimor

Norma aktuale e tatimit mbi fitimin eshte 15%. Shpenzimet e pazbritshme per efekt te tatimit mbi fitimin jane llogaritur ne perputhje me ligjin Nr. 8438 date 28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat"

Pershkrimi	31.12.2022	31.12.2021
Fitimi bruto	597,825,306	363,384,418
Shpenzime te panjohura		
Baza e llogaritjes se tatim fitimit	597,825,306	363,384,418
Perqindja e tatim fitimit	15%	15%
Tatim fitimi	89,673,796	54,507,663
Rezultati neto	508,151,510	308,876,755

24. Transaksionet me palet e lidhura

Hua nga shoqeri te lidhura 299,332,021

25. Angazhime dhe detyrime te mundshme

Gjate aktivitetit te saj te zakonshern shoqeria mund te perfshihet ne pretendime apo veprime te ndryshme ligjore nga pale te treta. Bazuar ne deklarimin e drejtuesve te shoqerise, nuk ka ngjarje te tilla.

26. Manaxhimi i riskut

(i) Risku i kredise

Rreziku i mospageses ekziston kur pala tjeter nuk mund te permbushet detyrimet per pagesen e llogarive te arketueshme. Maksimumi i rrezikut te kredise per instrumentet financiare jo-derivative eshte teorikisht i barabarte me vleren e drejte te te gjitha llogarive te arketueshme minus detyrimet kundrejt te njejtit debitor kur kompensimi eshte i lejuar. Rreziku i kredise i cili eshte identifikuar merret parasysh neperrnjete zhvleresimeve. Shoqeria ka politika per te siguruar se shitjet e mallrave dhe sherbimeve jane bere per klientet me nje histori krediti te pershtatshme, Shoqeria ka politika qe kufizojne sasine e ekspozimit te kredise per cdo kunderparti.

Ekspozimi ndaj riskut te kredise

Ekspozimi i Shoqerise ndaj riskut te kredise ne daten 31 Dhjetor 2022 dhe 2021 ka qene si me poshte:

Pershkrimi	31.12.2022	31.12.2021
Aktive te tjera financiare afatshkurter	885,766,461	823,302,241
Llogari te arketueshme	1,882,853,053	1,386,836,607

Llogari te tjera te arketueshme

Total	2,768,619,514	2,210,138,848
--------------	----------------------	----------------------

Levizja ne humbjen kumulative nga zhvleresimi ne llogarite e arketueshme gjate vitit eshte si me poshte

Pershkrimi	31.12.2022	31.12.2021
Me 1 janar 2022		
Humbja e njohur nga zhvleresimi		
Me 31 dhjetor 2022		

Total

Humbja nga zhvleresimi

Vjetersia e llogarive te arketueshrne ne daten e raportit paraqitet si me poshte

Pershkrimi	2022	2021
Te vjetra me pak se 1 vit		
Te vjetra me shume se 1 vit		
Zhvleresimi		

Gjendja ne fund te vitit

(ii) *Risku i likujditetit*

Shoqerise i duhet te mbuloje nevojat per likujditet nga operacionet e veta te kryerjesse sherbimeve. Prandaj mund te kete rreziqe qe nuk dote kete likujditetet te mjaftueshme per te paguar detyrimet sipas afateve ne kosto te arsyeshme. Shoqeria e rishikon riskun e likujditetit ne baza periodike ne menyre qe te manaxhohen detyrimet kur i vjen koha.

(iii) *Risku i interesit*

Shoqeria nuk ndeshet me risk interesi te flukseve monetare sepse ajo nuk ka instrumenta financiare me norma variabel dhe ka likuiduar huate e veta.

(iv) *Risku i kembimeve monetare*

Shoqeria kryen transaksione ne LEK, EUR dhe USD. Risku i kembimeve monetare menaxhohet duke zbatuar parimin e perputhjes midis te drejtave dhe detyrimeve. Shoqeria nuk ka kryer ndonje transaksion forward ose te produkteve derivative te fiksuar ne daten 31 Dhjetor 2022.

Kurset e kernbirnit qe jane perdorur ne fund te vitit:

1 Euro = 114.23 ALL

1USD = 107.05 ALL

27. Ngjarje pas mbylljes se bilancit

Mbas dates se mbylljes se bilancit nuk ka ndonje ngjarje te rendesishme e cila kerkon regullime te pasqyrave financiare apo dhenien e shpjegimeve plotesuese per to.

28. Rakordimi i shifres se afarizmit

Shitjet neto perfaqesojne te ardhurat e realizuara nga sherbimet e kryera e cila rakordon me deklaraten tatimore te TVSH.

HARTUESI PASQYRAVE FINANCIARE

JONA SOTA



ADMINISTRATORI

LEFTER SOTA

